



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 14 Prot.

Tiranë, më datë 11.01.2019

VENDIM

Nr. 16, datë 11.01.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, gërma d, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.01.2019, pasi shqyrtoi propozimin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimeve:

- për saktësim të njollës së objektit pasuri kulturore 2 godinat pjesë të “Aksi rrugës “Skëndërbej dhe godinat në të dy anët e kësaj rruge” (Blloku i Ambasadave), me kod në hartë (II-154)”, Tiranë sipas hartës bashkëlidhur, pika 45 e Urdhrit të Ministrit të Kulturës Nr. 276, datë 16.07.2015 për “Shpalljen Monument Kulture të Kategorisë së II-të të disa objekteve në qytetin e Tiranës”;;
- për saktësim të njollës së objektit pasuri kulturore Ish Pastërtia në Rr. e Kavajës”, me kod në hartë (II-101), Tiranë, shpallur nga Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Urdhër Nr. 122, datë 05.03.2007, pika 101;
- për mungesë të interesit kulturor për objektin “Banesa tip vile (1 kat) me kod II - 169, Qyteti i Tiranë, Rr. Asim Zeneli”, pika 60 e Urdhrit të Ministrit të Kulturës Nr. 276, datë 16.07.2015 për “Shpalljen Monument Kulture të Kategorisë së II-të të disa objekteve në qytetin e Tiranës”;

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Mirela KUMBARO FERXHI

